



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 130 prot.

Kamëz, më 10.11.2021

V E N D I M

Nr. 103 Datë 10.11.2021

MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE PËR HEDHJEN E SHORTIT TË CILËT PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT PËR OBJEKTET KOLEKTIVE, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 10.11.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt –Vendim Nr.96 Datë 10.11.2021** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”; Aktin Normativ Nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij; Vendimin Nr. 750, Datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar; Vendim Nr. 904, Datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe për zgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”; Vendim Nr.5, Datë 06.01.2020, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga program i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, Datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”; Vendim Nr. 887, Datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendimit Nr.22, Datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz, “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së subjekteve për hedhjen e shortit të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për objektet kolektive, që do të hidhen në short të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e listës së subjekteve përfituese për hedhjen e shortit, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga programi i rindërtimit të objekteve kolektive (Pallatet e Valiasit), banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019, sipas akt-ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Liçensave dhe Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

